



## **VENDIM MBI PAPANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 21 prill 2015**

**Numri i lëndës: 2014-31**

**K.P.**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 21 prill 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. Ryan, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 5 qershor 2014. Ankuesi ka kërkuar që emri i tij mos të bëhet publik. Paneli ka pranuar kërkesën e tij.

## **II. FAKTET**

2. Me 23 janar 2011, Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë ka ngritur aktakuzë ndaj ankuesit dhe ka akuzuar atë për vrasje të rëndë të gruas së tij, si dhe mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve.
3. Më 3 nëntor 2011, ankuesi ka kërkuar nga kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it që të caktojë lëndën tek një trup gjyqtarësh të EULEX-it. Më 15 nëntor 2011, kryetari ka hedhur poshtë kërkesën. Ai ka gjetur se nuk kishte asnjë arsye për të besuar se do të kishte keqpërdorim të drejtësisë apo vonesa të paarsyeshme procedurale, gjë që mund të kishte garantuar caktimin e lëndës gjykatësve të EULEX-it.
4. Më 2 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka dënuar ankuesin duke e dënuar me njëzet e një vjet burgim. Edhe ankuesi dhe prokurori kanë apeluar ndaj aktgjyqimit.
5. Më 24 tetor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës ka modifikuar aktgjykimin e shkallës së parë në disa aspekte dhe e ka vërtetuar atë për pjesën tjetër dhe ka rritur dënimin e ankuesit në njëzet e shtatë vite burgim.
6. Më 8 shkurt 2013, ankuesi ka paraqitur një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë si një mjet të jashtëzakonshëm juridik në Gjykatën Supreme. Ajo ishte hedhur poshtë si e pabazuar më 30 shtator 2013.
7. Më 20 shtator 2013, ankuesi ka dërguar një kërkesë në Zyrën e Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK) duke kërkuar që të ndërhyjnë në këtë rast. Më 1 tetor 2013, prokurori i EULEX-it dhe kryeprokurori i PSRK-së ishin përgjigjur se EULEX-i nuk kishte autoritet të anuloj apo kthej vendimet e gjykatave në Kosovë dhe ka refuzuar të ndërhyjë.

## **III. ANKESAT**

8. Ankuesi pohon se procedurat kundër tij ishin të padrejta dhe se ai ishte dënuar padrejtësisht. Ai gjithashtu ankohet se lënda e tij nuk është marrë përsipër nga EULEX-i.

## **IV. LIGJI**

9. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa)

dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

10. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
11. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
12. Paneli konstaton se në thelb ankesa e ankuesit ka të bëjë me rezultatin e procedurës gjyqësore ndaj tij dhe të gjoja dënimit të tij të padrejtë.
13. Paneli rithekson se ashtu siç ka konstatuar në shumë raste, sipas rregullës 25, paragrafi 1, i bazuar në konceptin e llogaridhënies të OPLAN-it të EULEX-it Kosovë, se në parim Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë as mbi fushën administrative e as mbi fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Ato hyjnë vetëm brenda kompetencave të gjykatave të Kosovës (shih ndër të tjera *Shaip Selmani kundër EULEX-it*, 2014-23, 10 Nëntor 2014, §12; *Gani Gashi kundër EULEX-it*, 2013-22, 7 prill 2014 § 11).
14. Si rezultat kjo ankesë nuk hyn në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë. Prandaj, kjo çështje nuk bie në kuadër të kompetencave të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë. Për më tepër, ankuesi nuk i ka ofruar Panelit ndonjë dëshmi të besueshme që do të mund të mbështeste pretendimin e tij për trajtim të padrejtë.
15. Për aq sa ankesa e ankuesit mund të kuptohet se ka të bëjë me refuzimin e EULEX-it për ta marrë përsipër lëndën e tij, edhe nëse supozojmë se ky vendim do të hynte brenda juridiksionit të Panelit, prapëseprapë ajo do të ishte e skaduar dhe për atë arsye do të ishte e papranueshme. Në pajtim me rregullën 25, paragrafin 3 të rregullores së punës, ankesa duhet të parashtrohet brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pretenduar. Paneli konstaton se vendimet e kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it dhe kryeprokurorit të PSRK-së janë dhënë më 15 nëntor 2011, përkatësisht më 1 tetor 2013. Ankuesi ka paraqitur ankesën e tij më 4 qershor 2014. Prandaj, ankesa nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës së Panelit. Për më tepër, ankuesi nuk i ka ofruar Panelit ndonjë tregues të besueshëm që sugjeron se dështimi i EULEX-it për të

marrë përsipër lëndën e tij ka rezultuar në shkeljen e të drejtave të tij themelore.

**PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi bie jashtë juridiksionit të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës; dhe në çfarëdo rasti, është qartësi e pabazuar brenda kuptimit të nenit 29 (e), prandaj

**SHBALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese